



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0752

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “N.T.P. Gresa Commerce” kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 13.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet për ngrohje” me nr. të prokurimit 624-23-6986-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 21.11.2023 merr këtë:

Vendim

1. Refuzohet ankesa e operatorit ekonomik OE “N.T.P. Gresa Commerce” me nr. 2023/0752 e datës 02.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 13.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet për ngrohje” me nr. të prokurimit 624-23-6986-1-1-1.
2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 13.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivi.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 08.07.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet për ngrohje” me nr. të prokurimit 624-23-6986-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 970,200.00€.

Me datë 13.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik “N.T.P. Burimi”.

Me 18.09.2023, operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 21.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Operatori Ekonomik Ankues me datë 02.10.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0752.

Paneli konstatoi paraprakisht se nuk ekzistojnë elemente për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. (mbajtur me 17.11.2023), sikurse parashihet me paragrafin 2, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, me ç ‘rast konstatohet se të dyja palët kanë qëndruar prapa pretendimeve të tyre, përderisa përfaqësuesi i AK ka deklaruar se nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Në kontekstin e analizimit të gjithmbarshëm të shkresave të kësaj lënde Paneli Shqyrtues krijoi mendimin e pavarur të tij/sajë duke konstatuar se:

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Pretendimet kryesore (themelore) të operatorit ekonomik ankues sa i përket referencave të kontestuara nga AK lidhur me punët e kryera për projektet e potencuara nga AK në letren standarde B42, deklaroi se i ka përmbushur për faktin se projektet janë kryer para afatit duke e përmbushur kontratën 100% dhe në disa 130% (+/-30% sasia indikative). Në kërkesë për rishqyrtim i kemi sqaruar në detaje pretendimet tona ankimore, ndërsa tek vendimi i AK-së për aprovimin e pjesërisht të kërkesës për rishqyrtim e njëjta e ka marr parasysh referencën për Shkollën fillore 8 dëshmorët - në Kralan dhe referencën Furnizim me pelet të lëshuar nga KK Klinë. Ndërsa dy referencat tjera të lëshuara nga Universiteti Haxhi Zeka nuk i ka marr parasysh. Po ashtu në vendimin për refuzim autoriteti kontraktues ka shtuar edhe një arsye të eliminimit ku e ka cekur se referenca e lëshuar nga Komuna e Prizrenit “Furnizim me dru zjarri”, nuk mund të merret parasysh sepse nuk është e përfunduar brenda tri viteve nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Referencat e lëshuara nga Universiteti Haxhi Zeka, janë përfunduar pa marr parasysh afatin e përfundimit të kontratë. Këto kontrata kanë qenë furnizim dhe të njëjtat përfundojnë me përmbushjen e sasisë së furnizimit. I sqarojmë panelit shqyrtues se kontrata

:Furnizim me pelet për ngrohje qendrore për fakultetin e biznesit MTHM-së-kontratë kornizë-Universiteti Haxhi Zeka”, e nënshkruar në vitin 2021 është përfunduar dhe pastaj UHZ ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin tjetër me titull “Furnizim me pelet për ngrohje qendrore në UHZ”-Kontratë kornizë-Universiteti Haxhi Zeka”, në vitin 2022, pra pas përfundimit të kontratës së nënshkruar në vitin 2021. Për të njëjtin aktivitet të prokurimit ne jemi shpallur fitues dhe kemi nënshkruar përsëri kontratën me titull “Furnizim me pelet për ngrohje qendrore në UHZ”. Edhe kjo kontratë është përmbushur dhe tani AK-Universiteti Haxhi Zeka përsëri ka publikuar njoftimin mbi vendimin për aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë- KONTRATË KORNIZË”, ku përsëri ne jemi rekomanduar për kontratë dhe kemi nënshkruar kontratën. Pra referencat e lëshuara nga Universiteti Haxhi Zeka e tregojnë qartë se aktivitetet për të cilat janë lëshuar referencat janë të përfunduara sepse janë nënshkruara kontrata pasuese të reja, ndërsa për kontratat paraprahe nuk mund të kërkohej dhe aplikohet ligjërisht +30% kur autoriteti kontraktues ka hy në marrëdhënie kontraktuale me kontratën e re të natyrës së njëjtë dhe me këtë kuptohet qartë se kontratat paraprahe kanë përfunduar. (Si dëshmi po i prezantojmë panelit kontratat e lartcekura për vitet 2021-2022 ku janë përmbushur këto kontrata dhe kontratën e nënshkruar të vitit 2023). Aplikimi i +30% është mundësi e lejuar e që është në kompetencë të AK-së në rast se paraqitet nevoja e shfrytëzimit të +30%, ndërsa aplikimi i +30% të sasive indikative nuk është obligative, por +30% është si prag apo tavan i sasive indikative. Kjo nënkupton se 70% e sasive indikative është pragu, ndërsa 130% është tavan i mundësisë së shfrytëzimit të sasive indikative. Nga këto faktet kuptohet se referencat e lëshuara nga UHZ, janë të vlefshme dhe është dashur të merren parasysh nga ana e AK-së. Gjithashtu ju sqarojmë se edhe nëse nuk llogariten kontratat/referencat e Komunës së Prizrenit dhe referencën e lëshuar nga kompania private Haxha Kom, ne e arrijmë vlerën prej 1,451,840.00 euro, ndërsa kësaj shume kur i shtohet edhe vlerat e referencave të lartpërmendura, ne e tejkalojmë edhe më shumë vlerën për kontrata të përfunduara në tri vitet e fundit. Gjithashtu edhe për referencën e lëshuar nga kompania Haxha Kom ne i kemi prezantuar edhe transaksionet bankare dhe librat e shitjes, ku shihet qartë se kontrata është përmbushur në tërësi, andaj edhe kjo referencë është dashur të merret parasysh.

Përfaqësuesi i AK: Oe ankues është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar dëshmi sipas DT në vlerë prej 1,400,000.00 euro, sa i përket kontratës me Universitetin Haxhi Zeka ne listën kontratave OE ka ofruar që ky aktivitet i OE për furnizimi përfundon me datën 18.04.2024 dhe atëherë komisioni gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka përputhshmëri mes listës dhe referencës të cilën e ka ofruar OE, dhe kjo del si e pa përfunduar. Sa i përket referencës me Haxhi Zekën OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe AK ja ka shqyrtuar kërkesën e OE dhe ne bazë të dokumenteve që OE ka ofruar për transaksione bankare kurse i njëkti përpos një pagese të cilën e ka me datën 03.04.2023 në vlerë 2400 euro, nuk ka prezantuar të tjera. Sa i përket referencës furnizim me pelet për ngrohje qendrore në U.Haxhi Zeka ka qenë e pa pranueshme pasi që ne reference shkruan qartë se kjo përfundon me datën 29.09.2023. Sa i përket listës së projekteve të OE që ka ngarkuar në ofertën e tij ku me numër rendor është numër 8, 9 dhe 10 lista e projekteve për pelet që ka ofruar OE, AK ka dërguar letrën standarde e për me na ofruar referenca për aktivitetet e përfunduara, por nuk na ka ofruar referencat të cilat AK i ka kërkuar. Gjithashtu edhe me listën e projekteve të realizuar për dru ku e ka me komunën e Prizrenit me numër rendor 1 kjo refrenc është e jashtaafatshme pasi që data e lëshuar e referencës është me datën 26.05.2020 ndërsa njoftimi për kontratë i AK ka qenë me datën 11.07.2023 të gjitha referencat të merren nga data 11.07.2020 deri me 11.07.2023. Andaj kjo referencë e ofruar nga OE ESHTË E PA PARANUSHME. Sipas listës është numër 2 numër 3 numër 4 numër 5 numër 6, 11, 12, 13, 14, 15 ndërsa edhe për listën e druve janë të pranuar 3 dhe 4 që arrijnë vlerën 1.180.866.86€

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP si dhe nenin 54 paragrafin 54.10 të RRPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 09.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të pretendimeve të operatorit ekonomik ankues. Me datë 25.10.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”*.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim:

“Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, sa i përket pretendimit të parë dhe të tretë lidhur me referencat të cilat AK gjatë vlerësimit e eliminon si arsye, në kërkesën për rishqyrtim ia merr si të bazuara, si dhe kërkesa për rishqyrtim i aprovohet pjesërisht e bazuar. Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, kontrata e cila skadon me datë 28.11.2023, AK -Komuna Klinë, AK ka iniciuar aktivitetet të prokurimit para kohe me qëllim që të sigurohet me kontratë, për arsye se sasia e parashikuar është shpenzuar para përfundimit të kontratës dhe në E-prokurim shohim kontratën e re për aktivitetin e njëjtë nga i njëjti autoritet, siç edhe pretendon OE ankuesi, pra kontrata në listë i bie se është e përfunduar, po ashtu edhe në referencë është e specifikuar se thuajse edhe sasia +30% gati është shpenzuar, dhe si e tillë AK -Klinë ka vazhduar me aktivitetet të ri të prokurimit, andaj nga sqarimet më lartë konsideroj se kjo referencë duhet të merret e mirëqenë, pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar. Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin sqaron se, ky pretendim nuk ka qenë i parashtruar në kërkesën për rishqyrtim, për faktin se kjo kontratë nga kompania Haxha Kom fillimisht është marrë si e mirëqenë sepse në ofertë i njëjti ka të bashkangjitura disa transaksione bankare, librat e evidentimit, dhe si e tillë, meqenëse AK konsideron se nuk ka dëshmi të mjaftueshme, atëherë gjatë procesit të rivlerësimit mund të kërkoj sqarime, konform nenit 72 të LPP. Nga kalkulimet e AK-së vlera 1,180,866.86 nëse i shtohen edhe referencat e Haxha Kom si dhe Komuna e Klinës, atëherë OE ankuesi e tejkalon vlerën 1,400,000.00 euro. Andaj si e tillë, meqenëse OE ankuesi ka ofertuar me çmimin më të ulët, po ashtu edhe kriteri është çmimi më i ulët, atëherë konstatoj se AK duhet që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj konform dispozitave ligjore të LPP, UPP dhe RRPP, për faktin se OE ankuesi pas këtyre sqarimeve në rivlerësim duhet të ishte i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” megjithatë me datën 21.11.2023 Eksperti ka sqaruar për panelin se pas konfirmimit zyrtar të UHZ, lidhur me referencat, i njëjti konfirmon se janë të përfunduara me datat: FURNIZIM ME PELET PËR

NGORHJEN QENDRORE PËR FAKULTETIN E BIZNESIT DHE MTHM-së- KONTRATË KORNIZË numër identifikues: uhz-21-496-1-2-1-22.08.2022 – e cila merret e mirëqenë ndërsa FURNIZIM ME PELET PËR NGROHJEN QENDRORE NE UHZ-ë- KONTRATË KORNIZË NR PROKURIMI uhz-22-8819-1-2-1 ka përfunduar 28.10.2023, nuk merret e mirëqenë, për faktin se data e njoftimit për kontratë është 10.07.2023. Si e tillë, kemi analizuar listën e kontratave edhe njëherë duke ia shtuar referencën e Haxha Com -213,958 euro si dhe referencën e UHZ të datës 22.08.2022 -49800 euro, totali i referencave shkon 1,348,241.86 euro, kurse kriteri i kërkuar nga AK është 1,400,000.00 euro, andaj sipas sqarimeve dhe në bazë të argumenteve OE ankuesi nuk e plotëson kriterin sa i përket listës së kontratave, andaj rekomandoj të mbetet vendimi i AK-së në fuqi.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se me datën 30.08.2023 gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik ankues lidhur me listën e kontratave të dorëzuar me rastin e ofertimit ashtu që të dorëzohen edhe referencat apo dëshmitë tjera përkatëse sipas dosjes së tenderit. Kurse sa i përket referencës lidhur me kontratën me Universitetin Haxhi Zeka, aty figuron se kjo kontratë është përfunduar me datë 28.09.2023 ndërsa publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë 08.07.2023 apo rreth njëmbëdhjetë (11) javë më herët. Në anën tjetër kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë për kontratat e realizuara respektivisht të përfunduara (jo në realizim e sipër) para datës së publikimit të njoftimit për kontratë. Paneli Shqyrtues po ashtu konsideron se tejkalimi i sasive totale indikative (+/- 30%) të kontratat publike kornizë nuk duhet të interpretohen si kontrata të ndara prej kontratës bazë. Kontratat e prokurimit publik të secilës natyrë pa dallim duhet të nënkuptohen si tituj ekzekutiv (justus titulus) respektivisht si punë juridike përmes të cilave themelohet një marrëdhënie e caktuar juridike detyrimore ndërmjet palëve kontraktuale. Në këtë drejtim edhe kontrata publike kornizë nuk mund të interpretohet si diçka e ndarë prej rasteve kur tejkalohen sasitë indikative pasi që tejkalimi në këtë rast mund të bëhet vetëm për arsye se kontrata bazë është aktive (pra është në realizim e sipër dhe nuk ka përfunduar ende). Pra është paradoksale që të thuhet se një kontratë ka përfunduar përderisa palët kontraktuese vazhdojnë të realizojnë të drejta dhe detyrime reciproke prej asaj kontrate. Përndryshe edhe në rastin hipotetik kur do të lidhej një ankesë i kontratës bazë, sërish aneksi do të ndante fatin e kontratës kryesore. Rastet kur një kontratë konsiderohet si e përfunduar janë të përcaktuara me Ligjin për

Marrëdhëniet e Detyrimeve përmes neneve 276 deri 374 dhe mund të manifestohen përmes përmbushjes, subrogimit, konfodimit, parashkrimit, etj. Përderisa nuk argumentohet se kontrata është përfunduar në njërin nga format e përcaktuara me ligjin përkatës në fuqi, kontrata e tillë nuk mund të interpretohet si aktive. Për këto arsye Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin e plotë por vetëm të pjesshëm vlerësimeve të ekspertit shqyrtues. Andaj sipas këtij paneli OE ankues nuk e arrinë vlerën e kontratave të realizuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit prej 1,400,000.00. ngase sipas dy listave të prezantuara nga OE ankues në ofertë (*listat në shkresat e lëndës*) të emërtuara "Lista e projekteve për dru" janë pranuar projektet nr. rendor 2,3 dhe 4 kurse nga "Lista e projekteve me pelet", projekti nr. rendor 1 i është pranuar vetëm vlera të cilën e ka të shprehur me referencë dhe po ashtu projektet me nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 11, 12, 14, 15. Ndërsa nuk i është pranuar kontrata me nr. rendor 16 për shkak se është e përfunduar pasi që është shpallur njoftimi për kontratë kurse të tjerat në mungesë dëshmie sipas DT. Andaj bazuar në kërkesat e vendosura në DT nga AK, Oe ankues ka ofruar dëshmi bindëse/argumentuar vetëm në vlerën prej 1,344,183,86 euro. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin e kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që ky aktiviteti i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP kurse kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1 dhe 6 të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*" kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me dru dhe pelet për ngrohje" me nr. të prokurimit 624-23-6986-1-1-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - N.T.P."GRESA - COMMERCE "**
- Arkivës së OSHP-së: